



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:088274

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05447659

KA.nr.520/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit M.B. B.I. me NUI 810771932 dhe me seli në rrugën “Konferenca e Bujanit” p.nr. në Pejë, për shkak të anulimit të vendimit administrativ, jashtë seancës më 12.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë padia e paditësit “M.B. B.I. me NUI 810771932, për anulim të aktit administrativ të papërcaktuar.

A R S Y E T I M

Paditësi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative më datë 27.07.2020, ka iniciuar konflikt administrativ me kërkesë anulim të aktit administrativ, të cilin nuk e kishte caktuar.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoj se padia kishte të meta pa evitimin e të cilave nuk mund të procedohet tutje, rrjedhimisht më 23.02.2024 mori aktvendimin KA.nr.520/22, me të cilin e ftoi Paditësin që t’i evitoj të metat e evidentuara nga gjykata. Me atë aktvendim gjykata gjithashtu e paralajmëroi Paditësin se nëse nuk i mënjanon të metat e padisë brenda afatit prej 8 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, atëherë gjykata do ta hedhë poshtë padinë në kuptim të nenit 33 par.2 të LKA-së.

Kjo gjykatë konstaton se paditësi më datë 28.02.2024 e ka pranuar aktvendimin KA.nr.520/22 të datës 23.02.2024, ndërsa deri me datën e nxjerrjes së këtij aktvendimi nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës të dhëna në aktvendimin e cekur më lartë. Sipas nenit 33 para. 2 të LKA-së “Nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të

atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm.”

Prandaj, meqenëse Paditësi nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës të caktuara në aktvendimin për korrigjimin e padisë, ndonëse ishte i paraprlajmëruar për pasojat, atëherë gjykata në bazë të nenit 33 para. 2 të LKA-së vendosi si në dispozitiv të këtij atkvendimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.520/22

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.